Republika e Kosovës
Komuna e Prishtinës

# Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, 16.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtines, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"Gerlica"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës kryesore dhe rrugicave në Bërnicë të poshtme"**, me Nr. të Prok: **616 20 154 521** nxjerr:

## VENDIM

1. ***Refuzohet*** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik 'Gerlica Company SHPK" të dt. 14.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit " NDERTIMI I RRUGES KRYESORE DHE RRUGICAVE NE BERNICE" me Nr.616 20 7033 521 Nr. Brendshëm 616 20 154 521,kundër *Njoftimit për kontrate]* te AK –së, të datës02.11,202 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. ***Vërtetohet njoftimin për kontrate* I publikuar me datë: 02.11.2020;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

## Arsyetim

Operatori Ekonomik **"Gerlica Company SHPK"** me datë 14.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:" **Ndërtimi i rrugës kryesore dhe**

**rrugicave në Bërnicë të poshtëm"**me Nr. të Prok:616 20 7033 521; me Nr. te brendshem te prokurimit:616 20 154 521, Autoriteti Kontraktues, me datë 17.12.2020 ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur si vijon:

-Pretendimi juaj se kerkesat per garancion te punimeve ne afat pese vjeçar nuk jane ne harmoni me kerkesat e tenderit eshte i pa bazuar,pasi qe Autoriteti Kontraktues ka kerkuar afatin e garancionit me qellim te stimulimit te realizimit cilesor te projekteve dhe se secili tenderues kete cilesi mund ta kalkuloj ne çmimin e tenderit te tij.Pra ketu nuk ka asgje diskriminuese as kufizuese,pasi q emund te marr pjese çdo OE-ik,por natyrisht duhet te kete kujdes ne vendosjen e çmimeve te cilat i sigurojne edhe sanimin e defekteve eventuale per pese vitet pas dorezimit te punimeve.

Lidhur me kete kemi kerkuar sqarim edhe nga Njesia e kerkeses dhe kemi marre pergjegje te ngjajshme dhe do t'ia bashkengjesim ketij Vendimi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

# RE: Kerkesa per rishqyrtim Gerlica-rruget ne Bernice

Halil Fejziu

Wed 12/16/2020 3:12 PM

To:Zeke Bardhaj <Zeke.Bardhaj@rks-gov.net>; Dugagjin Bucaj <dugagjin.bucaj@rks-gov.net>; Aferdita Hasimi <aferdita.hasimi@rks-gov.net>;

Cc:Gezim Mehmeti <gezim.mehmeti@rks-gov.net>;

Përshendetje:
Të nderuar duke u nisur nga pyetja për shkurtim të afatit të garancionit, ju njofojm se ky afat duhet të përfillet si ësht caktuar në kritere, në mënyrë që të kemi realizim më kualitativ të punimeve dhe përgjegjësi më serioze për shpenzimin e paras publike.

Me respekt:

Halil Fejziu
Zyrtar i lartë për ndërtim urban
Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të kontratave
Komuna e Prishtinës

e-mail: halil.fejziu@rks-gov.net
tel: 038 230-900 lok.1168
mob: +377 44 112-327

---

**From:** Zeke Bardhaj <Zeke.Bardhaj@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, December 15, 2020 9:36 AM
**To:** Halil Fejziu <Halil.Fejziu@rks-gov.net>; Dugagjin Bucaj <dugagjin.bucaj@rks-gov.net>; Aferdita Hasimi <aferdita.hasimi@rks-gov.net>
**Cc:** Gezim Mehmeti <gezim.mehmeti@rks-gov.net>
**Subject:** Fw: Kerkesa per rishqyrtim Gerlica-rruget ne Bernice

Te nderuar,
Ua percjell kerkesen per rishqyrtim ne te cilen pretenduesi kerkon shkurtimin e afatit te garancionit dhe mbajtjes se parase apo afatit te sigurimit te punimeve.Ju lutem e analizoni dhe na pergjigjeni lidhur me kete.

Me respekt,

**Zekë Bardhaj**
Udhëheqës i Prokurimit
Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës

**e-mail: zeke.bardhaj@rks-gov.net**
tel: +381 (0)38 224 869
mon: +377 (0)44 360 660

---

**From:** Kaltrina Dalipi
**Sent:** Monday, December 14, 2020 3:24 PM

**Me respekt,**
**Kaltrina Dalipi**
Zyrtare e Lartë e Prokurimit
Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës

**e-mail:** kaltrina.dalipi@rks-gov.net
tel: +381 (0)38 230 900 lok: 1129